

Roli i prindërve

Të vendos kufij.
Ekranet janë shumë
tërheqëse dhe
krijojnë lehtësisht
varësi.

Të kontrollojnë
përmbajtjen e
lojërave, videov
edhe filmave të
shikuar.

Të interesohet dhe
të flas me fëmijën
për ato që ai shikon
dhe bën në ekran.

Çdo ditë

Fikni televizionin
ose tjerat ekrane
nëse askush nuk i
shikon.

Pa ekran :
- gjatë kohës e të
ushqyerit
- në dhomën e gjumit
- në mëngjes para shkollës
- në mbrëmje një orë para
gjumit..

Ju jeni një
shembull për
fëmijën tuaj : keni
kujdes në
përdorimin e
ekraneve!

Përfundim

Ekranet zvogëlojnë shkëmbimet verbale
në familje dhe me bashkëmoshatarët;
megjithatë, fëmija rritet dhe zhvillon
komunikimin, gjuhën dhe mësimin e tij
përmes ndërveprimeve dhe manipulimeve
të objekteve. Atij i duhet një hapësirë
për të vepruar, folur dhe menduar.
Komunikimi, imitimi, manipulimi,
aktiviteti fizik, krijimtaria,
emocionet dhe sjellja shoqërore
nuk mund të mësohen
në ekrane !



Vizatim nga Francesco Tonucci
Përdorim i autorizuar

Më pak ekran është më mirë për fëmijët !

Përmëtej

- REPER : <https://prevention-ecrans.ch/>
- CSA: <https://www.csa.fr/Proteger/Protection-de-la-jeunesse-et-des-mineurs/La-protection-des-tout-petits>
- Libër për fëmijë : « Nathan est accro aux écrans »
de Julie Hausler, édition Helvetia

Realizuar nga Sophie Castella dhe Danièle von der Weid Horner
Logopedët ARLD-FR
Përkthyer në Shqip nga Hikmete Prebreza
Frizi nga Catherine Bratschi
Nëntor 2020

Ekranet ku ... ?



Vizatim nga Francesco Tonucci
Përdorim i autorizuar

**Për zhvillimin e
komunikimit, gjuhës dhe të
mësuarit :**

Le të qëndrojmë vigjilentë !
Të respektojmë nevojat e fëmijës.

Rreziqet që lidhen me ekranet

(Telefon, tablet, televizion, kompjuter)

Në zhvillimin e komunikimit, të folurit dhe të mësuarit shkollorë :

Rreziku i zhvillimit në një çrregullim të shkëmbimit (shikimit, dëgjimit, përgjigje).

Dy orë qëndrim para ekranit gjatë ditës tek fëmijët në moshën 2 deri 4 vjet, e trefishon rrezikun në një vonesë të folurit.

Fëmijët që qëndrojnë shumë kohë para ekranit statistikiqsh paraqesin më shumë dështime në shkollë.

Vëmendja është shumë më e dobët tek fëmijët të cilët kanë përdor ekranin në mëngjes para se të mbërrinte në shkollë sesa fëmijët e tjerë që nuk kanë pasur çasje në ekran.

Në zhvillimin global me efekte në :

Motivim 
Përqendrim 
Shëndetin fizik 
Menaxhimin i emocioneve 

Gjumë 
Socializim 
Vizion 

Çfarë të bëjmë ?

Para 3 viteve

Fëmija e ndërton vetën dhe mëson të flasë me njerëzit. Ata janë një model për komunikimin, gjuhën dhe emocionet. Me ta, ai mëson të dëgjoj, shikoj, imitoj.

Këshillë : pa ekran

Çfarë bën fëmija pa ekran ?

Fëmija eksploron, rregullon, çrregullon, transporton, shkarravitet. Ai zhagitet, ecë, ngjitet. Ai imiton njerëzit përreth tij. Ai gumëzhit, tregon, këndon, dëgjon përralla.

Nga 3 deri 6 vjet

Fëmija ka nevojë të përjetojë dhe të jetë me objekte reale që mund t'i manipulojë dhe t'i transformoj. Atij i pëlqen të zbulojë ambientin e tij dhe të shpikë histori. Ai interesohet për të tjerët, ai e ka kohën për të mësuar rregullat shoqërore.

Këshillë : në varësi të moshës, nga 20 minuta në një orë në ditë, me mbështetjen e prindërve.

Çfarë bën fëmija pa ekran ?

Aktivitetet fizike : ai shëtitet, mëson të bëjë biçikletë, trotinet, vrapon, luan me top, shkon në këndet e lodrave.

Aktivitetet e komunikimit dhe gjuhës: ai tregon, pyet, merr pjesë në biseda, lexon libra, dëgjon përralla, rima, këndon.

Aktivitetet krijuese: ai vizaton, pret, ngjit, luan në rërë, në ujë, maskohet, luan me kukulla, kafshë, makina, bën ndërtime, luan sikur janë duke gatuar, shoqëron nënën, babanë në detyrat e shtëpisë (gatim, pastrim, punëdore).

Aktivitetet shoqërore : ai merr pjesë në lojëra tavoline, ai takon tjerë fëmijë, mëson të luaj me ta, të ndajë.

Pas 6 vitesh

Fëmija interesohet për botën. Ai thëllon mësimin e tij. Ai ka nevojë për vëmendje dhe mbështetje në arritjet e tij, të vazhdojë të luajë, të eksplorojë, të provojë dhe të bëjë gabime.

Këshillë : kontrolloni përdorimin e ekraneve dhe internetit; kufizoni kohëzgjatjen dhe përmbajtjen sipas moshës së fëmijës.

Çfarë bën një fëmijë pa ekran ?

Ai vazhdon dhe zgjeron zbulimin e tij të aktiviteteve siç përshkruhen për fëmijët midis 3 dhe 6 viteve. Ai tregon çfarë ka përjetuar, shpjegon atë që mendon, fillon të lexojë dhe të shkruajë, merr pjesë në punët e shtëpisë dhe shoqërohet gjithnjë e më shumë.

